

2023

EIB NË NJË VËSHTRIM

BEI në një vështrim

© **Banka Evropiane e Investimeve, 2023.**

98-100, boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

+352 4379-1

info@eib.org

www.eib.org

twitter.com/eib

facebook.com/europeaninvestmentbank

youtube.com/eibtheeubank

Të gjitha të drejtat të rezervuara

Të gjitha pyetjet mbi të drejtat dhe licensimin duhet të dërgohen në

publications@eib.org

Për informacion të mëtejshëm lidhur me aktivitetet e BEI-t, ju lutemi konsultohuni me faqen e internetit, www.eib.org

Gjithashtu, ju mund të kontaktoni tek info@eib.org

Merrni buletin të elektronik në www.eib.org/sign-up

Fuqia e natyrës është e jashtëzakonshme. Gjatë gjithë historisë, njerëzit kanë pasur frikë nga stuhitë, përmytjet, thatësitat dhe shpërthimet e saj. Në këtë kohë kritike, ne e kuptojmë se duhet të jemi në harmoni me natyrën dhe të shfrytëzojmë fuqinë e saj, nëse duam të mposhtim ndryshimin e klimës të shkaktuar nga veprimet tona. Më shumë se gjysma e investimeve të Bankës Evropiane të Investimeve kanë të bëjnë me masat për klimën dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Prioriteti ynë është financimi i tranzicionit të gjelbër drejt burimeve të rinovueshme të fuqizuara nga natyra, duke kaluar nga energjia gjeotermale tek hidrocentralet dhe energjia e erës. Kjo është arsyeja pse ne po i vendosim këto forca natyrore në kopertinat e raporteve tona kryesore këtë vit.

© Meritat e fotos: EIB, Eggtronic, Anaconda Biomed, GettyImages, Shutterstock.

Botuar nga Banka Evropiane e Investimeve.

Printuar në letër FSC®.

BEI NË NJË VËSHTRIM

Banka Evropiane e Investimeve (BEI) është bankë e Bashkimit Evropian. Ne jemi institucioni financiar shumëpalësh më i madh në botë dhe një nga ofruesit më të mëdhenj të financave në masat për klimën.

Që nga themelimi i saj në vitin 1958, BEI ka investuar mbi një trilion euro në projekte në Evropë dhe vende në mbarë botën. Duke qenë se masat për klimën janë pjesë e gjithçkaje që bëjmë, aktivitetet tona fokusohen në fushat e mëposhtme prioritare: klima dhe mjedisi, zhvillimi, inovacioni dhe aftësitë, bizneset e vogla dhe të mesme, infrastruktura dhe kohezioni.

Fondi Evropian i Investimeve, i cili është pjesë e Grupit të BEI-t, është i specializuar në mbështetjen e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme me financimin e bizneseve të reja, rritjes, inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit, punësimit dhe zhvillimit rajonal.

BEI punon me institucione të tjera të BE-së për të nxitur integrimin evropian, për të promovuar zhvillimin në Bashkimin Evropian dhe për të mbështetur politikat e BE-së. Kjo punë shtrihet përtej Evropës: BEI është aktive në mbi 160 vende dhe përmirëson jetën e miliona njerëzve çdo vit brenda Bashkimit Evropian dhe në mbarë botën.

Ndërlidhja ka qenë në qendër të punës së BEI-t gjatë gjithë historisë sonë. Në të gjithë Evropën, investimet e BEI-t i afrojnë vendet e BE-së. Nëpërmjet BEI Globale, e cila u ngrit në vitin 2022 për të rritur ndikimin e financave tona të zhvillimit, ne ndihmojmë në adresimin e sfidave globale dhe nxisim rritjen e mundësitë në të gjitha kontinentet.

Në një kohë kur vlera e multilateralizmit vihet në dyshim, puna e BEI-t shërben si një kujtesë e vazhdueshme e fuqisë së përpjekjeve të integruara evropiane.



Me përhapjen e COVID-19, bota u përball me urgjenca të menjëhershme shëndetësore dhe ekonomike. Kishte një nevojë urgjente për të gjetur një vaksinë dhe zgjidhje për të kufizuar përhapjen e virusit. BEI ka financuar zhvillimin dhe prodhimin e vaksinave kundër COVID-19 dhe ka dhënë mbështetje thelbësore për masat e tjera të kujdesit shëndetësor si brenda Bashkimit Evropian ashtu edhe përtej tij. Grupi i BEI-t ka kontribuar gjithashtu ndjeshëm në masat e BE-së për të frenuar efektet ekonomike të krizës në bizneset dhe ekonominë evropiane.

Me fillimin e zbutjes së krizës së shkaktuar nga COVID-19, Rusia pushtoi Ukrainën, duke ndezur një krizë të re globale. Si pjesë e një përgjigjeje ndërkombëtare ndaj krizës, banka ka mobilizuar mbështetje financiare përmes Paketës së Solidaritetit të BEI-t për Ukrainën për të ndihmuar vendin në përmbushjen e nevojave urgjente. Përveç kësaj, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, BEI po punon për sigurimin e financimeve të mëtejshme për të ndihmuar qeverinë në mbajtjen e shërbimeve publike kritike për njerëzit që kanë qëndruar në Ukrainë.

Si huadhënësi më i madh shumëpalësh në botë, BEI i ndihmon ekonomitë të lulëzojnë, duke krijuar vende pune dhe promovuar barazinë e qëndrueshmërinë. Ne punojmë me partnerë publikë dhe privatë dhe matim suksesin tonë me atë se sa puna jonë e ndihmon shoqërinë dhe e përmirëson jetën e njerëzve që prek.

Investimet e BEI-t po mbështesin në mënyrë aktive tranzicionin e gjelbër. Si banka e BE-së për klimën, BEI po ndihmon në përmbushjen e angazhimeve të Marrëveshjes së Parisit - traktatit ndërkombëtar për ndryshimet klimatike - dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara përmes veprimeve të saj në mbarë botën. Ne kemi zotuar një vlerë prej një trilion euro në investime për klimën dhe qëndrueshmërinë mjedisore gjatë dekadës së ardhshme.

NDIKIMI YNË NË VITIN 2022

**260
miliardë
euro**

në investime të mbështetura
nga aktivitetet e BEI-t

**4,9
trilionë
euro**

në investime të mobilizuara
në përgjithësi

**72,45
miliardë
euro**

në financime të përgjithshme
të Grupit të BEI-t

**36,5
miliardë
euro**

në investime të gjelbra

**44,28
miliardë
euro**

të mbledhura në tregjet e
obligacioneve

**14,11
miliardë
euro**

në financime për bizneset
e vogla

**18,72
miliardë
euro**

në financime për energji të
qëndrueshme dhe burime
natyrore

**15,52
miliardë
euro**

për të nxitur inovacionin,
kapitalin digjital dhe njerëzor

**5,3
milionë***

vende pune të ruajtura në
bizneset e vogla

* Shifrat lidhen me NVM-të/me kapital të mesëm që përfituan nga mbështetja e BEI-t në vitin 2022 ose nga mbështetja e FEI-t midis tetorit 2021 dhe shtatorit 2022, si rezultat i operacioneve të nënshkruara me ndërmjetës deri në fund të vitit 2022.



Financimi i BEI-t në vitin 2022 arriti vlerën 65,15 miliardë euro, duke përfshirë aktivitetet e BEI Globale në vlerë 10,82 miliardë euro*

**25,4
milionë**

njerëz pinë ujë më të sigurt

**8,5
milionë**

shtëpi furnizohen me energji
elektrike

**17
milionë**

njerëz përfitojnë nga
përmirësimi i infrastrukturës

**6,6
milionë**

abonentë të rinj me
shërbimet 5G të aktivizuara

**570,1
milionë**

udhëtime shtesë me
transport publik

234 700

njerëz përballen me më pak
rrezik nga përmbytjet

15 800 MW

kapaciteti i prodhimit të energjisë
elektrike, 100% nga burime të
rinovueshme

**3,1
milionë**

refugjatë ukrainas në qendrat
e pritjes ose në objektet e
akomodimit të përkohshëm

**150,4
milionë**

njerëz përfitojnë nga
shërbimet e përmirësuara
shëndetësore, duke përfshirë
vaksinat kundër COVID-19

* Financimi total i Grupit të BEI-t jashtë Bashkimit Evropian përfshin — përveç BEI Globale — projekte nga FEI jashtë Bashkimit Evropian dhe projekte të BEI-t në Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë.



MBËSHTETJE PËR UKRAINËN



Banka Evropiane e Investimeve i qëndron pranë autoriteteve ukrainase dhe popullit të Ukrainës. Ajo mbështet një Ukrainë të pavarur.

Si pjesë e një përgjigjeje të koordinuar të BE-së dhe ndërkombëtare ndaj kësaj krize, banka ka mobilizuar mbështetje financiare përmes Paketës së Solidaritetit të BEI-t për Ukrainën për të ndihmuar qeverinë në përmbushjen e nevojave urgjente për likuiditet. Përveç kësaj, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, BEI po punon për sigurimin e financimit të mëtejshëm për t'i mundësuar Qeverisë së Ukrainës që të vijojë ofrimin e shërbimeve publike kritike për njerëzit që kanë qëndruar në vend, duke siguruar që ushqimet, furnizimet mjekësore dhe karburantet të mbeten në dispozicion, ndërkohë që BEI po mbështet gjithashtu transportin, energjinë, zhvillimin urban dhe projektet digjitale. Dy paketa kryesore financimi u miratuan në vitin 2022:

- Një paketë e parë me vlerë 668 milionë euro u miratua menjëherë pas fillimit të luftës, për të ndihmuar qeverinë të kryejë pagesat për nevojat urgjente.
- Një paketë e dytë me vlerë 1.59 miliardë euro u miratua për riparimin e infrastrukturës së dëmtuar dhe rifillimin e projekteve kritike, e cila u nënshkrua në korrik 2022. Pak më shumë se 1 miliardë euro nga kjo paketë u disbursua për të ndihmuar vendin në riparimin e rrugëve, urave dhe hekurudhave të dëmtuara.

Instituti i BEI-t, krahu social dhe kulturor i bankës së BE-së, ofroi gjithashtu 2,5 milionë euro ndihmë humanitare për ukrainasit e prekur nga lufta. Banka ndihmoi në ripërdorimin e granteve me vlerë 59 milionë euro për riparimin e trenave dhe hekurudhave në Ukrainë, instalimin e urave të përkohshme të shkatërruara nga lufta dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor e strehimit të njerëzve të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre.

Banka ofroi gjithashtu grante me vlerë rreth 18 milion euro për Ukrainën nga Fondi i Mirëbesimit i Asistencës Teknike të Partneritetit Lindor për të ndihmuar komunitetet të kujdesen për rreth 700 000 njerëz që janë larguar nga shtëpitë e tyre. Fondi i partneritetit mbështetet nga Austria, Franca, Gjermania, Letonia, Lituania, Polonia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar. BEI po vijon punën me partnerët evropianë për të eksploruar mundësi të mëtejshme për mbështetjen e Ukrainës dhe refugjatëve të Ukrainës.






BEI po i jep Spindiag GmbH një hua me vlerë 15 milionë euro, për të financuar zhvillimin e platformës së testimit diagnostikues, të bazuar në PCR të kompanisë së re, e cila do të përdoret në institucionet e kujdesit shëndetësor.

COVID-19

BEI ka qenë në vijën e parë të reagimit global të Bashkimit Evropian ndaj pandemisë së COVID-19 dhe është bashkuar me organizatat ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët për të ndërmarrë veprime të menjëhershme.

Mbështetja e urgjencës nga Grupi i BEI-t u ka mundësuar ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrjeve inovative të investojnë pavarësisht pasigurisë ekstreme. Ne presim të mobilizojmë një vlerë prej 200 miliardë euro në financime së bashku me Fondin tonë Evropian të Garancisë, duke mbështetur kompanitë e qëndrueshme të prekura nga pandemia.

BEI ka ndihmuar gjithashtu në financimin e zhvillimit dhe blerjes së vaksinave COVID-19, zgjidhjeve për të kufizuar përhapjen e virusit dhe projekteve të tjera të shëndetit publik që lidhen me krizën e shkaktuar nga COVID-19.



Gjatë pandemisë, BEI financoi sipërmarrjen italiane "Eggtronic", e cila ka shpikur një konvertues energjie elektrike që kursen energji. Për shkak të efikasitetit të tyre të lartë të energjisë, konvertuesit "Eggtronic" kanë një gjurmë karboni shumë më të vogël se pajisjet e ngjashme.



KLIMA DHE ENERGJIA

Ndryshimet klimatike janë sfida më e madhe globale e brezit tonë. Arritja e objektivave klimatike do të përcaktojë mirëqenien e fëmijëve tanë. Objektivat e BEI-t për klimën dhe energjinë po vendosin standarde të reja në Evropë dhe më gjerë. Ne nuk i mbështesim më projektet e karburanteve fosile dhe do t'i kushtojmë 50% të investimeve tona masave për klimën dhe qëndrueshmërisë deri në vitin 2025.

Agresioni i Rusisë në Ukrainë e ka shtyrë Evropën në një krizë energjetike, duke e bërë nevojën për veprim edhe më urgjente. Pushtimi na ka kujtuar rëndësinë e ruajtjes së sigurisë së furnizimit tonë me energji elektrike - energjia është një çështje sigurie dhe dekarbonizimi është një çështje e autonomisë strategjike.

Operacionet e BEI-t përshpejtojnë rritjen e gjelbër dhe dekarbonizimin e ekonomive. Ne mbështesim projektet për efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme, të cilat ndihmojnë në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe forcimin e sigurisë sonë energjetike. Të gjitha veprimet tona kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme sociale dhe ekonomike.

Investimet e BEI-t trajtojnë gjithashtu efektet e ndryshimeve klimatike në komunitetet e cënueshme, duke mbrojtur biodiversitetin dhe duke promovuar bujqësinë e qëndrueshme. Ne i ruajmë burimet natyrore dhe po e bëjmë mjedisin të sigurt për brezat e ardhshëm. Çdo projekt që BEI mbështet, qoftë për inovacion, biznese të vogla apo infrastrukturë, duhet të jetë në përputhje me qëllimet tona klimatike.





BEI mbështeti "Anaconda", një kompani spanjolle pioniere që ka zhvilluar një trajtim me kosto efektive, e cila i ndihmon mjekët të shpëtojnë jetë dhe redukton humbjen e aftësive pas ishemisë.

INOVACION

Inovacioni e mban Evropën konkurruese dhe krijon vende pune me vlerë të lartë. BEI mbështet shumë faza të inovacionit, duke mbështetur idetë që përmirësojnë standardet e jetesës.

Ne mbështesim kërkimin dhe zhvillimin në shkallë të gjerë, si dhe firmat e vogla e të specializuara. Investimet tona në sektorë të tillë si telekomunikacioni, aviacioni, mjekësia dhe digjitalizimi janë një vullë miratimi që tërheq financime shtesë nga sektori privat për këto projekte. Grupi i BEI-t u mundëson kompanive evropiane të krijojnë dhe zhvillojnë teknologji më të avancuara.

Me kreditë e BEI-t, universitetet ndërtojnë dhe zgjerojnë objektet e tyre kërkimore, dhe sipërmarrjet rrisin stafin e përmirësojnë pajisjet e tyre. Me mbështetjen e BEI-t, idetë më inovative kthehen në suksese biznesi.



BEI është huadhënësi kryesor për bizneset e vogla në Ballkanin Perëndimor, ku ka ndihmuar rreth 30 000 kompani dhe mbështetur gjysmë milioni vende pune. Si rezultat i punës sonë, mbi 1 800 shkolla në Serbi kanë lidhje më të shpejtë në internet dhe pajisje digjitale më të mira, duke u mundësuar mësuesve që të ofrojnë mësim në distancë për nxënësit në shtëpi gjatë pandemisë.

PËRFSHIRJE

BEI fuqizon bizneset e vogla dhe të rinjtë dhe mbështet gratë sipërmarrëse, duke u dhënë atyre akses në kredi dhe trajnime. Ne mundësojmë që njerëzit me të ardhura të ulëta, të vetëpunësuarit dhe mikrondërmarrjet të marrin financime dhe këshilla biznesi për t'u siguruar që projektet e tyre të kenë sukses.

Zakonisht, ne nuk japim hua më shumë se gjysmën e vlerës së kostos së një projekti. Përfshirja e BEI-t ka për qëllim të veprojë si një katalizator në përfshirje më të madhe të sektorit privat, duke rritur investimet në projekt.





QËNDRUESHMËRIA

BEI mbledh para duke emetuar bono në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Vlerësimi ynë i shkëlqyer i kreditit na lejon të mbledhim fonde me norma të mira dhe këto përfitime u kalohen klientëve.

Ekspertët e BEI-t për kapitalin krijuan dhe zhvilluan tregjet e gjelbra dhe të qëndrueshme të obligacioneve. Ne jemi emetuesi më i madh mbikombëtar i bonove të gjelbra, të cilat mbështesin energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, ujin e pastër dhe kanalizimet.



Orange Money

5.000 F

TRANSFERT DE CREDIT
RECHARGE

100 F

1500

Orange Money

100 F

KAWASAKI



Bizneset e vogla në Kongo morën kredi nga BEI gjatë pandemisë me një normë interesi të drejtë, në vend të normave shumë të larta të huadhënësve informalë, duke i ndihmuar këto biznese dhe komunitetet e tyre.

BEI GLOBALE

BEI Globale, krahu i zhvillimit të BEI-t, u krijua në vitin 2022 për të rritur ndikimin e financave tona të zhvillimit. BEI ka investuar më shumë se 70 miliardë euro jashtë Bashkimit Evropian gjatë dekadës së fundit (2012-2022), duke mobilizuar miliarda investime çdo vit nga sektori privat. BEI Globale përforcon ndikimin e BEI-t, duke u afruar më shumë me komunitetet, kompanitë dhe institucionet lokale në mbarë botën.

BEI do të zgjerojë mbështetjen e saj për institucionet lokale mikrofinanciare në rajone ku njerëzit shpesh nuk kanë akses në banka. Kur njerëzit mund të marrin kredi, bizneset punësojnë më shumë punëtorë, gratë bëhen të pavarura, zhvendosja reduktohet dhe familjet mund të dalin nga varfëria.

Ne do të rrisim ekspertizën sektoriale të BEI-t në nivel lokal, duke ndarë njohuritë dhe përvojën tonë me partnerët lokalë. Ne ofrojmë këshilla të pavarura, duke u mbështetur në përvojën e fituar nga puna në një gamë të gjerë vendesh dhe sektorësh. Këto shërbime këshillimore mund të shoqërojnë produktet financiare të BEI-t, por ata gjithashtu mund të ofrohen të pavarura nga çdo financim.



Ndryshimet klimatike, pandemia COVID-19 dhe krizat e tjera kërkojnë që miliardat që investojmë me bankat tona partnere ndërkombëtare dhe kombëtare të shndërrohen në trilionë përmes partneriteteve të reja dhe punës së vijuar me institucione të tjera financiare globale. Më e rëndësishmja, përfshirja e BEI-t inkurajon përfshirjen e sektorit privat, i cili tërheq investime të reja.

Vetëm vendet në zhvillim kanë nevojë për më shumë se 2 trilionë euro investime shtesë vjetore për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe ambiciet e Marrëveshjes së Parisit për adresimin e ndryshimeve klimatike.

Si banka e BE-së për klimën, BEI po punon në mbështetje të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, plani i Bashkimit Evropian për t'u siguruar që politikat e saj për klimën, energjinë, transportin dhe taksat të reduktojnë emetimet e gazeve serrë me të paktën 55% deri në vitin 2030 (krahasuar me nivelet e vitit 1990). Bashkimi Evropian, megjithatë, përbën vetëm 10% të emetimeve globale, kështu që BEI Globale do të ndihmojë në shtrirjen e përpjekjeve të Evropës për dekarbonizimin përtej kufijve të saj, duke mbështetur një Marrëveshje të Gjelbër Globale.

BEI Globale është një aleat kyç i Komisionit Evropian në programin e tij Porta Globale (Global Gateway) prej 300 miliardë euro për të mbështetur projekte që përmirësojnë lidhjen globale dhe rajonale në digjitalizim, klimë, transport, shëndetësi, energji dhe arsim. Huadhënia për zhvillim dhe partneritetet financiare përshpejtojnë rritjen, i bëjnë zonat rurale më të begata, duke i bërë qytetet më novatore dhe të forcojnë ekonominë.

BEI Globale mbështet vendet që përpiqen të përmirësojnë barazinë gjinore dhe të fuqizojnë gratë në vendin e punës, duke u angazhuar me bizneset e udhëhequra nga femrat. Ne ndihmojmë miliona njerëz që nuk kanë akses në ujë të pastër, energji elektrike, vaksina, kujdes të mirë shëndetësor dhe sisteme të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve.





ANGAZHIMI YNË

Banka Evropiane e Investimeve është përgjegjëse ndaj qytetarëve të BE-së. Banka mbështet projekte që promovojnë prioritetet dhe objektivat e Bashkimit Evropian, duke përfshirë qëndrueshmërinë klimatike dhe mjedisore, inovacionin dhe aftësitë, infrastrukturën, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kohezionin dhe zhvillimin. BEI siguron që të gjitha projektet që ajo mbështet – qofshin ato në sektorët e energjisë, transportit, industrisë apo bujqësisë – të jenë në përputhje me qëllimet e Marrëveshjes së Parisit. Stafi ynë përfshin ekonomistë, inxhinierë, analistë financiarë dhe specialistë të klimës që punojnë çdo ditë me ekspertë vendas, institucione dhe qeveri në të gjithë globin.



Grupi i BEI-t përbëhet nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI) dhe Fondi Evropian i Investimeve (FEI).

BEI është bankë e Bashkimit Evropian. Është huamarrësi dhe huadhënësi shumëpalësh më i madh në botë. Me qendër në Luksemburg, banka ka një rrjet të madh zyrash vendore dhe rajonale në Evropë dhe më gjerë.

FEI mbështet bizneset e vogla, duke përmirësuar aksesin e tyre në financa në Evropë dhe në një sërë vendesh jashtë Evropës. FEI harton dhe zhvillon kapitalin e sipërmarrjes dhe rritjes, garancitë dhe instrumentet mikrofinanciare për të promovuar inovacionin dhe punësimin.

BEI Globale është krahu i zhvillimit ndërkombëtar të BEI-t. E themeluar në vitin 2022, BEI Globale vazhdon angazhimin dhjetëvjeçar të BEI-t për financimin e zhvillimit, masave për klimën, inovacionin dhe qëndrueshmërinë në mbarë botën.